



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	1575/2023
Data	28.03.2023
Signature	<i>Adnan Kuj</i>
PRISHTINË, PRISTINA, PRISHITKA	

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 79/2023
Datë:28.03.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4), nenin 14 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.8) të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.02/L-088 për Trashëgimi Kulturorë, Rregulloren Nr. 11/2022 për Inventarizimin dhe Procesin e Përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, si dhe në standardet e udhëzimet profesionale të aplikueshme, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi me numër të referencës 01/2023 i datës 27.03.2023 dhe me numër protokolli 1538/2023 i datës 27.03.2023, i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave/propozimeve për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme të Aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturorë të cilat mund të jenë pjesë përbërëse/potenciale të Trashëgimisë Kulturorë për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme të asetit "Shtëpia e Teqesë së Bektashinjve".
2. Obligohet QRTK-Prizren që asetin sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi ta regjistrojë në databazë, t'i japë numrin unik, ta kategorizojë sipas Ligjit në fuqi dhe ta përfshijë në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, në Kategorinë Trashëgimi Arkitekturorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Profesional Shqyrtues i kërkesave/propozimeve për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të Aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturore të cilat mund të jenë pjesë përbërëse/potenciale të trashëgimisë Kulturore, i emëruar me Vendim të Ministrit të MKRS-së, me numër 67/2023, të datës 21.03.2023, me numër protokolli 1454/2023, të datës 22.03.2023, është mbledhur më datë 27.03.2023 dhe pas shqyrtimit të propozimit të ndërtesës: Shtëpia e Teqesë së Bektashinjve në Prizren

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.02/L-088 për Trashëgimi Kulturore, Rregulloren Nr. 11/2022 për Inventarizimin dhe Procesin e Përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje, si dhe në standardet e udhëzimet profesionale të aplikueshme:

Rekomandon

Përfshirjen e Teqesë së Bektashinjve në Prizren, në Listën e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme

Emri i asetit: Shtëpia e Teqesë së Bektashinjve,
Adresa: rr. William Woker, ngastra 2729-1 në Prizren,
Shek: XX
Numri unik: 0621
Kategoria: Trashëgimi Arkitekturore

Në bazë të Vendimit të Ministrit të MKRS-së, me numër 67/2023, të datës 21.03.2023, me numër protokolli 1454/2023, të datës 22.03.2023, është formuar Komisioni Profesional Shqyrtues për shqyrtim të propozimeve të reja për mbrojtje të përkohshme të asetëve me potencial të trashëgimisë kulturore.

Komisioni në përbërje të:

Merita Augustini Nrecaj-kryesuese, DTK;

Milot Mustafa, DTK;

Valdet Devaja, DTK;

Edona Arifi, konsulente DTK.

Është mbledhur më datë 27.03.2023 për ta shqyrtuar propozimin Shtëpia e Teqesë së Bektashinjve.

Znj. Drenushe Behluli Mehmeti, nuk ka marrë pjesë për arsye se ndodhet në pushim mjekësor.

Propozimi për shqyrtim dhe përfshirje në mbrojtje ka ardhur nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane – Selia e Shenjtë, Tiranë, më datë 25.08.2022, me numër protokolli 4022/2022, të datës 09.09.2022.

DTK e ka njoftuar QRTK-Prizren në lidhje me kërkesën, dhe ka kërkuar që të vazhdohet me procesin e inventarizimit dhe procedurave të tjera në bazë të Ligjit të Trashëgimisë kulturore në fuqi, në lidhje me vlerësimin e një asemi për mbrojtje të përkohshme.

Më datë 02.02.2023 QRTK Prizren e ka njoftuar Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit se në përputhje me mandatin dhe në zbatim të akteve nënligjore të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore për inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së trashëgimisë kulturore në mbrojtje, se QRTK Prizren ka filluar procesin e inventarizimit dhe dokumentimit, dhe se ka filluar përgatitjen e dosjes për mbrojtje të përkohshme pasi që është evidentuar se ndërtesa

posedon vlera kulturore-historike, dhe se për çdo ndërhyrje duhet të kërkohet leje nga institucionet kompetente.

Më 28.02.2023, QRTK Prizren përmes shkresës me numër protokolli 59, të datës 28.02.2023, e ka dorëzuar në DTK dhe IKMM propozimin për përfshirje të Shtëpisë së Teqesë së Bektashinjve me numër unik 0621 në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme.

Më datë 24.03.2023 në DTK është pranuar shkresa e IKMM-së me numër protokolli 143, e datës 24.03.2023, me të cilën është dhënë rekomandimi i IKMM-së, respektivisht i Komisionit Profesional Shqyrtues në kuadër të IKMM-së për vlerësim të dosjeve për përfshirje në listën e TK-së, me Vendimin me nr. 20 të datës 23.03.2023.

Komisioni i IKMM-së ka rekomanduar përfshirjen e Teqesë së Bektashinjve në Prizren, në Listën e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme.

Komisioni Shqyrtues Profesional në DTK, pas pranimit të rekomandimit nga Komisioni Shqyrtues Profesional IKMM, është mbledhur më datë 27.03.2023, dhe ka shqyrtuar dosjen complete:

-Dosjen nga IKMM

-Dosjen nga QRTK Prizren

-Dosjen nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane

Në bazë të dosjeve të dorëzuara, formularit të inventarizimit, fotove dhe përshkrimeve të vlerave të kësaj ndërtese, Komisioni konstaton se ndërtesa posedon vlera të larta estetike, që shprehen përmes arkitekturës së veçantë, vlerë historike, shkencore e shoqërore, për arsye të vjetërsisë së saj, mënyrës së ndërtimit, si dhe rëndësisë së lartë të memories kolektive të komunitetit fetar bektashian si dhe të gjithë qytetarëve të Prizrenit, por edhe më gjerë. Këto vlera janë theksuar edhe në Deklaratën e Rëndësisë në formularin e inventarizimit të QRTK Prizren me numër 10435-13 dhe numër unik 0621.

Komisioni Shqyrtues Profesional në DTK Rekomandon:

Shtëpia e Teqesë së Bektashinjve, me adresë rr. William Woker, ngastra 2729-1 në Prizren, me numër unik 0621 në databazën e trashëgimisë kulturore, të përfshihet në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme në Kategorinë Trashëgimi Arkitekturore.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- Komisionit Profesional Shqyrtues në DTK;
- IKMM-së;
- Komisionit Profesional Shqyrtues në IKMM;
- QRTK Prizren;
- Komunës së Prizrenit;
- Palës;
- Departamentit Ligjor;
- Institucioneve vartëse të trashëgimisë kulturore;
- Arkivit të MKRS-së.

